

**BULETIN I VENDIMEVE GJYQËSORE**

**VOLUMI 11**

**(Janar-Qershor 2022)**

Përmbajtja

|  |    |
|--|----|
| PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE ..... | 4  |
| 1. Vendim nr.987, datë 31.03.2022.....                   | 4  |
| 2. Vendim nr.1224, datë 19.04.2022.....                  | 7  |
| 3. Vendim nr.250, datë 22.06.2022.....                   | 9  |
| 4. Vendim Nr. (82-2021-1282) 368, datë 17.11.2021.....   | 14 |

Në zbatim të nenit 28, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve publikon në faqen e saj të internetit çdo gjashtë muaj një buletin informues mbi vendimet e formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit, të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese për çështjet tatimore, me qëllim informimin e tatimpaguesve dhe në bazë të të cilave, për raste të unifikuara, reflekton rast pas rasti vendimet teknike, të cilat zbatohen për raste të tjera të ngjashme.

Ky buletin përmban disa njohuri bazë mbi hapat që ndiqen nga tatimpaguesi gjatë procedurës së ankimit, si dhe përmbledhje të disa vendimeve të formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit, për çështjet tatimore. Ai është hartuar me një gjuhë të thjeshtë, por duke iu përmbajtur me saktësi terminologjisë ligjore të përdorur në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Informacion më të detajuar mund të gjeni në faqen tonë të internetit: <https://www.tatime.gov.al>

Qasja e lirë në legjislacionin tatimor dhe rregulloret e përditësuara, është e aksesueshme lehtësisht në linkun: <https://www.tatime.gov.al/c//legjislacioni>

### ***Shënim!***

*Informacioni i paraqitur në këtë material përshkruan situatën, sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Ky legjislacion mund të jetë objekt ndryshimi apo shfuqizimi. Informacioni ka vetëm qëllim informimi dhe nuk duhet të konsiderohet si këshillim apo opinion ligjor. Për zgjidhjen e një rasti specifik kërkoni ndihmë profesionale.*

## PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE

### 1. Vendim nr.987, datë 31.03.2022

#### Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë

**Paditës:** Shoqëria “Q.Zh” OJF, me NIPT \_\_\_\_\_,

**Të Paditur** DRT Tiranë;  
Drejtoria e Apelimit Tatimor

**Objekti:** 1. Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ “Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore nr.\_\_\_\_ Prot., datë 04.08.2021 dhe Vendimit nr.\_\_\_\_ Prot., datë 20.12.2021 të DAT.  
2. Zgjidhjen e pasojave të dala nga këto akte.

**Shuma e detyrimit:** 252.454 lekë

**Baza Ligjore:** Ligji 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, nenet 109/3 dhe 119, neni 30 i ligjit 8483 “Për tatimin mbi të ardhurat”, neni 15 i ligjit nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”

#### Përmbledhje e Fakteve:

DRT Tiranë, me aktin administrativ “Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore” nr.\_\_\_\_ Prot., datë 04.08.2021, ka njoftuar subjektin “Q.ZH” OJF, me NIPT \_\_\_\_\_, për detyrimet e lindura në shumën totale 252.454 lekë, nëpërmjet shërbimit postar.

Bashkëlidhur Njoftim Vlerësimi nr.\_\_\_\_ Prot., datë 04.08.2021, administrata tatimore ka arsyetuar detyrimet që kanë lindur si pasojë e shkeljeve ligjore nëpërmjet Aktit të Vlerësimi Tatimor nga Zyra, në 2 (dy) faqe, si më poshtë:

Akti i Vlerësimi nga Zyra mbështetet në:

- Nenet 68, 71, 72, të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e

Shqipërisë”, i ndryshuar,

- Shkresën me nr.\_\_\_\_ Prot., datë 21.06.2021, të Drejtorisë së Hetimit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme, Sektori i Hetimit, protokolluar në DRT Tirane me nr.\_\_\_\_ Prot., datë 23.06.2021, që ka të bëjë me dërgimin e dokumentacionit dhe kërkesës për vlerësim tatimor.
- Shkresën me nr.\_\_\_\_ Prot., datë 01.04.2020, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, përkatësisht Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik, ku kërkohet të kryhen verifikimet dhe veprimet e mëtejshme lidhur me kontratën e shërbimit nr. \_\_\_\_ Prot., datë 28.05.2019 lidhur midis “Q.ZH” OJF me NIPT \_\_\_\_\_ dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Referuar Kontratës së Shërbimit nr.\_\_\_\_ Prot, datë 28.05.2019, përcaktohen objekti “Përgatitja e projektit \_\_\_\_\_”, kushtet e kontratës, vlera e kontratës, mënyra e pagesës dhe specifikohet se Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë shumën totale prej 10,000 euro përfshirë taksat, shuma e cila do të mbulohet nga projekti nën zërin WPO dhe pagesa do të kryhet sipas faturës së dhënë nga kontraktuesi.

Sipas sistemit tatimor C@TS rezulton se shoqëria “Q.ZH” OJF me NIPT \_\_\_\_\_ me datë krijimi 07.05.2014, me datë regjistrimi në organin tatimor 28.05.2014, rezulton i regjistruar me përgjegjësi tatimore si më poshtë:

- Tatimi mbi fitimin dhe TVSH,
- Me status: Aktiv në datë 28.05.2014.
- Tatimpaguesi ka të dorëzuara në sistemin tatimor deklarata të TVSH-së nga muaj maj 2014 deri më dhjetor 2020 dhe rezulton i çregjistruar nga përgjegjësitë tatimore TVSH në datën 31.12.2020.
- Nga verifikimi i situatës tatimore rezulton se subjekti ka deklaruar librat e shitjes dhe blerjes nga muaji maj 2014 deri më prill 2015.
- Sipas informacionit të zyrës së financës të D.R.T Tiranë rezulton se tatimpaguesi ka tërhequr bllok TVSH me numër serial \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_.

Subjekti duke mos qenë dakord me keto detyrime, ka ankimuar aktin administrativ në DAT, ku ka kërkuar shfuqizimin e aktit administrativ nr.\_\_\_\_ Prot., datë 04.08.2021 për detyrime dhe gjoha në shumën 252.454 lekë (Detyrimet përbëhen nga shuma 207.100 lekë).

Rezulton e provuar se DAT me vendimin e arsyetuar në 3 (tre) faqe, me nr.\_\_\_\_ Prot., datë 20.12.2021, ka vendosur:

- *Refuzimin e ankimit administrativ, për shkak se nuk janë përmbushur kërkesat e nenit 107 të ligjit 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, subjekti nuk ka paguar shumën e plotë të detyrimit, para skadimit të afatit të ankimit.*

Subjekti duke mos qenë dakord me këtë vendim ka ngritur padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila pasi e shqyrtoi në tërësi çështjen, në lidhje me themelin e çështjes vlerësoi se:

## Vlerësimi i Gjykatës

Në lidhje me sa u pretendua nga ana e palëve në gjykim, Gjykata, referuar rrethanave të faktit, provave të shqyrtuara në seancë gjyqesore si dhe shkakut ligjor të padisë, çmon se kërkimet e palës paditëse janë të pabazuara në ligj dhe në prova dhe se kërkesëpadia e paraqitur prej saj duhet rrëzuar duke arsyetuar si më poshtë:

Rastet e pavlefshmërisë absolute janë parashikuar në mënyrë shteruese në nenin 108 të ligjit 44/2015, Kodi i Pr.Administrative, ligj ky në fuqi në kohën e nxjerrjes së akteve administrative objekt gjykimi, ku parashikohet se:

*Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme:*

***a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me:***

***i) kompetencën e organit publik;***

***ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ose***

***iii) formën ose elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit;***

***b) është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën vepër penale;***

***c) ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjislacionit penal;***

***ç) në çdo rast tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj.***

Në shqyrtimin e pavlefshmërisë gjykata nuk shqyrton thelbin e tij por mjaftohet vetëm me verifikimin e shkaqeve të pavlefshmërisë absolute, sipas përcaktimeve të nenit 108 të K.Pr.Administrative.

Në rastin në gjykim gjykata konstaton se nuk ndodhemi para asnjërit prej rasteve të pavlefshmërisë absolute, të parashikuara nga dispozita ligjore cituar më sipër.

Gjykata konstaton se akti administrativ “Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore” nr.\_\_\_\_, dt.04.08.2021, është nxjerrë nga një organ i identifikuar, siç është Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, e cila është organi i caktuar me ligj që ka të drejtë të nxjerrë Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore të tatimpaguesit të regjistruar ne organin tatimor.

Gjykata konstaton po ashtu se akti administrativ objekt gjykimi është nxjerrë në përputhje me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji, në përputhje me nenin 99 të K.Pr.Administrative (forma dhe elementët e aktit) si dhe në përputhje me nenin 69, pika 2 të ligjit 9920/2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, pra është akt i rregullt, si në formë ashtu edhe në përmbajtje, ku ka të përcaktuar organin që e ka nxjerrë, identifikimin e palëve që u drejtohet, shpjegimin e rrethanave dhe fakteve që janë bërë shkas për nxjerrjen e aktit (sic është vlerësimi nga zyra për detyrimin tatimor të TVSH dhe gjobës përkatëse) dhe bazën ligjore në të cilën mbështetet nxjerrja e aktit, pra ligji 9920/2008, nenet 68, 71 dhe 72.

Element i rëndësishëm i vlefshmërisë së aktit është edhe respektimi i procedurës së parashikuar në ligj, e cila rezultoi të jetë respektuar sipas nenit 68 të ligjit 9920/2008, pika 4 dhe 5, neni 71, pika 1 gërma b.

Pra, në rastin konkret organi tatimor është vënë në dijeni nëpërmjet shkresës së DHT me nr.\_\_\_\_, datë 21.06.2021, për shkeljet e evidentuara nga Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik, nga e cila është kërkuar të verifikohen veprimet në kontratën e shërbimit nr.\_\_\_\_, dt.28.05.2019.

Sa me sipër, në rastin konkret pala paditëse “Q.ZH” OJF, ka zhvilluar veprimtari ekonomike, pasi ndërmjet kësaj të fundit dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është lidhur kontrata e shërbimit nr.\_\_\_\_, dt.28.05.2019, me objekt “Përgatitja e projektit \_\_\_\_\_” me vlerë 10.000 Euro, përfshirë taksat. Në vijim të kontratës paditësi “Q.ZH” OJF, ka lëshuar faturën tatimore të shitjes nr.\_\_\_\_, dt.04.12.2018, në vlerën 10.000 euro, pa llogaritur dhe paguar TVSH në masën 20% të faturës.

## **Vendimi i Gjykatës**

- ✓ Rrëzimin e kërkesëpadisë

## **2. Vendim nr.1224, datë 19.04.2022**

### **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**

**Paditës:** “Gj.A.A” Ent Publik me NIPT \_\_\_\_\_

**Të paditur:** DRT Tiranë  
Drejtoria e Apelit Tatimor

**Objekti:** 1. Shfuqizimi i vendimit nr.\_\_\_\_, datë 14.02.2022, i DAT  
2. Shfuqizimin e Njoftim Vlerësimit Tatimor nr.\_\_\_\_ Prot., datë 13.12.2021, të nxjerrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë.

**Shuma e detyrimit tatimor: 402 928 lekë**

### **Baza Ligjore:**

1. Ligj 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar;
2. Kodi i Procedurave Administrative;
3. Neni 106 e vijues i ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

## **Përmbledhje e Fakteve:**

Me njoftim vlerësimin nr. \_\_\_\_ Prot., datë 13.12.2021, të nxjerrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, tatimpaguesi është njoftuar për gjoba dhe kamatëvonesa për pagesë të vonuar të sigurimeve shoqërore në periudhat 2019, 2020 dhe 2021.

Tatimpaguesi kërkon anulimin e gjobave, duke pretenduar se ka qenë i detyruar për të zbatuar Vendimin Gjyqësor nr.\_\_\_\_, datë 14.07.2021, të Gjykatës Administrative të Apelit, i cili urdhëron palën e paditur të paguaj pagën e paditësve ndihmësit ligjor në masën 75 përqind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit. Pagesa e kësaj difference sipas vendimit gjyqësor është kryer me vonesë për arsye të akordimit të fondeve. Me shkresën nr.\_\_\_\_, datë 16.11.2021, është miratuar fondi i kërkuar dhe titullari i institucionit nxori urdhrin nr.\_\_\_\_, datë 14.07.2021. Nga rideklarimi në SIT i pagesave rezultojnë gjoba për pagesë të vonuar si dhe kamatëvonesat të cilat nuk janë rezultat i një deklarimi të vonuar por nga rideklarimi i të dhënave i detyruar nga një vendim gjyqësor. Për sa më sipër është kërkuar anulimi i gjobave dhe kamatëvonesave sipas Njoftim Vlerësimi nr. \_\_\_\_ Prot., datë 13.12.2021, nxjerrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë.

## **Vlerësimi i Gjykatës**

Referuar parashikimeve ligjore në fuqi, detyrimet tatimore përcaktohen me ligj. Detyrimi tatimor përfshin tatimin, kamatëvonesat si dhe gjobat, për rastet e parashikuara nga ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në rastin konkret detyrimi tatimor në formë gjobash dhe kamatëvonesash ka lindur për pagesë të vonuar të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe Tap për periudhën 2019, 2020 dhe 2021, bazuar kjo në nenet 76 dhe 114 të ligjit nr 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Këto penalitete janë vendosur mbi detyrimet e deklaruara dhe të paguara nga pala paditëse për sigurime dhe për tatim mbi të ardhurat personale në zbatim të vendimit gjyqësor titull ekzekutiv vendimit nr. \_\_\_\_, datë 14.07.2021, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Këto detyrime janë paguar në zbatim të vendimit gjyqësor, pasi është kthyer në titull dhe është bërë i detyrueshëm për zbatim. Pra shkak i pagimit të tyre dhe vonesa lidhen me vendimin gjyqësor (kohën kur ai është bërë i detyrueshëm për zbatim nga pala paditëse) dhe jo me mosveprimet e palës paditëse, pra jo për faj të kësaj të fundit.

Gjithashtu Gjykata e gjen të pabazuar argumentin e dhënë nga pala e paditur Drejtoria e Apelit Tatimor, në bazë të të cilit ka lënë në fuqi aktin Njoftim Vlerësimi të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë dhe sipas të cilit për sa kohë që ky rast nuk gjen parashikim në ligj, atëherë detyrimi qëndron. Përkundrazi, kuptimi i ligjit është që detyrimet tatimore përcaktohen në ligj dhe në mungesë të parashikimit ligjor ato nuk mund të aplikohen. Pra, nuk mundet sistemi elektronik i tatimeve apo palët e paditura si organe publike të përcaktojnë detyrime apo penalitete për situata që ligji nuk i rregullon

shprehimisht.

Në këto kushte, Gjykata çmon se akti objekt gjykimi “Njoftim Vlerësimi Tatimor” nr.\_\_\_\_Prot., dt.13.12.2021, është i pabazuar në ligj dhe prova dhe si i tillë duhet shfuqizuar. Po kështu dhe akti që e ka lënë në fuqi atë, vendimi nr.\_\_\_\_, datë 14.02.2022, i Drejtorisë së Apelit Tatimor, është i pabazuar dhe duhet shfuqizuar. Kërkesë padia është e bazuar dhe duhet pranuar.

## **Vendimi i Gjykatës**

✓ *Pranimin e kërkesëpadisë*

### **3. Vendim nr.250, datë 22.06.2022**

#### **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**

#### **Paditës: Subjekti “PB” PF**

**Të paditur:** Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë  
Drejtoria e Apelit Tatimor Tiranë

**Objekti:** - Deklarimin e pavlefshmërisë absolute të Njoftim Vlerësimit nr.\_\_\_\_ Prot., datë 13.04.2016, për pagesën e TVSH-së në shumën 560,000 lekë dhe Njoftim Vlerësimit nr.\_\_\_\_ Prot., datë 13.06.2016, për pagesën e TVSH-së në shumën 8,301,360 lekë.

- Deklarimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr.\_\_\_\_Prot., datë 28.07.2016, të Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë.

**Shuma e detyrimit tatimor:** Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore nr.\_\_\_\_ Prot., datë 13.04.2016, i Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë për detyrimin në zërin TVSH në shumën 8,301,360 lekë në total për periudhën 2015/01, 2015/02, 2015/03, 2015/04, 2015/5, 2015/6, 2015/07, 2015/08, 2015/09, 2015/10.

Njoftim Vlerësimi nr.\_\_\_\_, Prot., datë 13.04.2016, i nxjerrë nga DRT Sarandë për penaltetin në zërin TVSH në shumën 560,000 lekë gjobë. Periudha 2014/12.

**Baza Ligjore :** Neni 109 i ligjit nr.9920/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenet 32, 152, 154 të K.Pr.Civile; Udhëzimi nr.19, datë 03.11.2014 “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar”, neni 9, 10 i tij; Neni 108 i Kodit të Procedurave Administrative.

#### **Përmbledhje e fakteve:**

Tatimpaguesi P.B me Nipt \_\_\_\_\_, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër me kërkesëpadinë me objekt: *Deklarimin e pavlefshmërisë absolute të Njoftim Vlerësimit për detyrimet nr.\_\_\_\_ Prot., datë 13.04.2016, për pagesën e TVSH-së në shumën 560,000 lekë dhe*

*Njoftim Vlerësimit nr. \_\_\_ Prot., datë 13.06.2016, për pagesën e TVSH-së në shumën 8,301,360 lekë. Deklarimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. \_\_\_ Prot., datë 28.07.2016, të Drejtorisë së Apelit të Tatimor Tiranë.*

Akti administrativ Njoftim Vlerësimi nr. \_\_\_ Prot., datë 13.04.2016, është nxjerrë nga DRT Sarandë bazuar në Aktin e Rivlerësimit “Për Formularin e Deklarimit dhe Pagesës së TVSH-së” nr. \_\_\_ Prot., datë 24.11.2015, i mbajtur nga inspektori i Drejtorisë së Vlerësimit, Përpunimit dhe Mbledhjes së të Ardhurave në DRT Sarandë. Ky akt rivlerësimi ka nxjerrë detyrimet në zërin TVSH, për tatimpaguesin P.B, pasi ky tatimpagues ka vepruar në kundërshtim me përcaktimet e nenit 8, pika 4 të UMF nr.19, datë 03.11.2014 “Për zbatimin e regjimit të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar”.

Konkretisht ky tatimpagues, i cili është aplikues i skemës së kompensimit të fermerëve, rezulton se nuk ka depozituar akt-marrëveshjet me fermerët e deklaruar në librin e blerjeve për periudhën janar-tetor 2015, si dhe fermerët e deklaruar në librin e blerjeve nuk janë pajisur me NIPT në kohën kur janë kryer blerjet.

Për këtë procedurë të kryer në kundërshtim me parashikimet ligjore, nga ana e DRT Sarandë është kryer rivlerësim i detyrimeve duke i nxjerrë detyrimet në zërin TVSH, për periudhën janar-tetor 2015 në shumën 8,301,360 lekë.

Akti administrativ Njoftim Vlerësimi nr. \_\_\_ Prot., datë 13.04.2016, është nxjerrë nga DRT Sarandë bazuar në Aktin e Rivlerësimit “Për Formularin e Deklarimit dhe Pagesës së TVSH-së” nr. \_\_\_ Prot., datë 07.12.2015, i mbajtur nga inspektori i Drejtorisë së Vlerësimit, Përpunimit dhe Mbledhjes së të Ardhurave në DRT Sarandë. Ky akt rivlerësimi ka nxjerrë penalitetin në zërin TVSH, për tatimpaguesin P.B, pasi ky tatimpagues ka vepruar në kundërshtim me përcaktimet e nenit 8, pika 4 të UMF nr.19 datë 03.11.2014 “Për zbatimin e regjimit të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar”.

Konkretisht ky tatimpagues, i cili është aplikues i skemës së kompensimit të fermerëve, rezulton se nuk ka depozituar akt-marrëveshjet me fermerët e deklaruar në librin e blerjeve për periudhën janar-tetor 2015, si dhe fermerët e deklaruar në librin e blerjeve nuk janë pajisur me NIPT në kohën kur janë kryer blerjet. Për këtë procedurë të kryer në kundërshtim me dispozitat ligjore, nga ana e DRT Sarandë bazuar në nenin 115 të ligjit nr.9920/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është nxjerrë penaliteti në zërin TVSH, në shumën 560,000 lekë.

Tatimpaguesi P.B, ka ankimuar në DAT Tiranë aktet administrative të nxjerra nga DRT Sarandë, konkretisht Njoftim Vlerësimin nr. \_\_\_ Prot., datë 13.04.2016 dhe Njoftim Vlerësimin nr. \_\_\_ Prot., datë 13.04.2016. DAT Tiranë me vendimin e saj nr. \_\_\_ Prot., datë 28.07.2016, ka vendosur:

*Refuzimin e ankimit për Njoftim Vlerësimin nr. \_\_\_ Prot., datë 13.04.2016, për TVSH-në në shumën 560,000 lekë dhe Njoftim Vlerësimin nr. \_\_\_ Prot., datë 13.04.2016, për TVSH-në në shumën 8,301,360 lekë, të nxjerrë nga DRT Sarandë, pasi mungon dokumentacioni që vërteton pagesën e detyrimit tatimor, objekt apeli.*

Më pas ky tatimpagues ndoqi rrugën e ankimit gjyqësor ndaj këtyre akteve administrative, duke iu drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër me kërkesëpadinë me objekt:

*Deklarimin e pavlefshmërisë absolute të Njoftim Vlerësimit nr. \_\_\_ Prot., datë 13.04.2016, për pagesën e TVSH-së në shumën 560,000 lekë dhe Njoftim Vlerësimit nr. \_\_\_ Prot., datë 13.06.2016,*

*për pagesën e TVSH-së në shumën 8,301,360 lekë.*

*Deklarimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. \_\_\_ Prot., datë 28.07.2016, të Drejtorisë së Apelit Tiranë.*

Kjo çështje pasi u gjykua nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, kjo e fundit me vendimin e saj nr.759 datë 01.12.2016 ka vendosur:

*- Pranimin e padisë.*

*- Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Njoftim Vlerësimit për detyrimet tatimore nr. \_\_\_ Prot., datë 13.04.2016, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë, për pagesën e TVSH-së në shumën 8,301,360 lekë.*

*- Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Njoftim Vlerësimit për detyrimet tatimore nr. \_\_\_ Prot., datë 13.04.2016, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë, për pagesën e TVSH-së në shumën 560,000 lekë.*

*- Shfuqizimin e aktit administrativ- vendimit nr. \_\_\_ Prot., datë 28.07.2016, të Drejtorisë së Apelit Tiranë.*

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim DRT Sarandë në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë pasi mori në shqyrtim në dhomë këshillimi këtë çështje administrative, me vendimin e saj nr.250, datë 22.06.2022, ka vlerësuar se:

### **Vlerësimi i Gjykatës:**

Fillimisht kjo gjykatë vlerëson se pala paditëse krahas pretendimit për pavlefshmëri absolute në formë, i shtrin pretendimet e tij dhe për pavlefshmëri relative të akteve objekt shqyrtimi. Në lidhje me këto kërtime, që lidhen me pavlefshmërinë relative të aktit administrativ, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se paditësi nuk ka shteruar ankimin administrativ sipas ligjit 9920/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kjo referuar përcaktimeve të nenit 107 të këtij ligji dhe për pasojë nuk plotësohet një nga kushtet formale të padisë të përcaktuara nga neni 16.1 të ligjit 49/2012 në të cilin përcaktohet se: “Padia ndaj veprimit administrativ ngrihet vetëm pas shterimit të ankimit administrativ”.

Nga aktet e marra në shqyrtim nuk rezulton që paditësi të ketë paguar detyrimin tatimor të caktuar në Njoftim Vlerësimit objekt shqyrtimi gjyqësor dhe, për pasojë DAT ka refuzuar marrjen në shqyrtim të ankimit administrativ. Në këto rrethana Gjykata Administrative e Apelit nuk merr në shqyrtim paligjshmërinë relative të akteve, shkaqet relative të ngritura në padi me të cilat kundërshtohet akti administrativ objekt shqyrtimi, pasi për këtë çështje padia e paditësit nuk plotëson kushtet formale të saj.

Në këto kushte gjykata i analizon pretendimet dhe prapësimet e palëve në lidhje me pavlefshmërinë absolute të akteve administrative objekt shqyrtimi gjyqësor, në referim të përcaktimeve të nenit 108 të ligjit 44/2015 të K.Pr.Administrative dhe nenit 108/1/6 të Ligjit 9920/2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke qenë se shkak i ngritur nga paditësi për paligjshmërinë dhe i pranuar dhe nga gjykata e shkallës së parë, ka qenë mosrespektimi i procedurës së nxjerrjes së aktit.

Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se Gjykata e Shkallës së Parë Gjirokastër ka dalë në konkluzione të gabuara që nuk merr parasysh faktin se në aktin administrativ Njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr. \_\_\_ Prot., data e vendosur në këtë akt është data 10.12.2015, pra akti administrativ është nxjerrë tre ditë pasi është mbajtur Akt-Rivlerësimi nr. \_\_\_ Prot., datë 07.12.2015,

i cili i është njoftuar palës paditëse së pari në rrugë elektronike në faqen personale të këtij subjekti. Data tjetër e vendosur në këtë akt është data 13.04.2016 dhe është data kur është tërhequr akti nga pala paditëse pranë DRT Sarandë.

E njëjta situatë paraqitet dhe me Njoftim Vlerësimin nr.\_\_\_\_ Prot., data e vendosur në këtë akt është data 25.11.2015, pra akti administrativ është nxjerrë një ditë pasi është mbajtur akt rivlerësimi në faqen personale të këtij subjekti. Data tjetër e vendosur në këtë akt 13.04.2016, është data kur është tërhequr akti nga pala paditëse pranë DRT Sarandë. Sistemi i ri tatimor C@TS bën të mundur hedhjen e të gjitha dokumentave që kanë lidhje me tatimpaguesit online dhe të gjitha subjektet kanë akses për të kontrolluar të gjitha detyrimet, mënyrën e nxjerrjes së tyre si dhe të gjitha aktet e shkresat që kanë të bëjnë me detyrimet tatimore të subjekteve nëpërmjet këtij sistemi online, në faqet e tyre personale elektronike. Data e aktit administrativ Njoftim Vlerësimi nr.\_\_\_\_, datë 10.12.2015 dhe aktit nr.\_\_\_\_, datë 25.11.2015, janë përkatësisht datat e hedhjes në sistem të këtyre akteve administrative, me të cilin është njoftuar pala paditëse, ndërsa data 13.04.2016 është data ku ky akt është tërhequr dorazi nga pala paditëse, duke i vendosur këtë datë me qëllim për ti ardhur në ndihmë tatimpaguesve për të ndjekur rrugën administrative të ankimit, brenda afateve ligjore.

Gjithashtu Kolegji konstaton se pala e paditur ka ndjekur procedurën në zbatim të nenit 23, pika 1 dhe 2 të Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 ‘Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar.

Kolegji vlerëson se pretendimi se akti administrativ objekt ankimi është nxjerrë jashtë afatit të përcaktuar ligjor, është i gabuar për faktin se palës paditëse i janë komunikuar vlerësimet dhe komunikimet zyrtare së pari në rrugë elektronike si e kërkon ligji dhe më pas janë tërhequr nga pala paditëse pranë DRT Sarandë.

Vlerësohet në këtë vendim se aktet administrative objekt shqyrtimi gjyqësor janë nxjerrë në respektim të formës dhe procedurës së kërkuar sipas nenit 68, pika 1, gërma a dhe nenit 69, pika 2, të Ligjit 9920/2008 ‘Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar.

Po kështu Njoftim Vlerësimet për detyrimet tatimore nr.\_\_\_\_Prot., datë 13.04.2016 dhe nr.\_\_\_\_Prot., datë 13.04.2016, të nxjerra nga DRT Sarandë, janë nënshkruar nga Drejtori Rajonal dhe vulosur me vulën e Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë, që përmban të gjithë elementët e domosdoshëm që parashikon Kodi i Procedurave Administrative për një akt administrativ, duke qenë se krijojnë pasoja juridike në rastin e paditësit dhe e ngarkojnë me detyrime në organin tatimor.

Gjykata Administrative e Apelit vlerëson gjithashtu se DRT Sarandë ka pasur kompetencë të plotë në nxjerrjen e këtyre akteve administrative, në kuptim të pikave 70.1 dhe 70.2 të UMF nr.24/2008 ‘Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar, pasi subjekti P.B ushtron aktivitetin e tij nën juridiksionin e DRT Sarandë dhe është pikërisht kjo e fundit e cila ka në kompetencë të kontrollojë rregullshmërinë e zbatimit të kuadrit ligjor tatimor të këtij subjekti, si dhe të nxjerrë Njoftim Vlerësimin për detyrimet tatimore për konstatimet e kryera.

Gjykata e Apelit ka vlerësuar se pretendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë i bazuar tek pretendimet e palës paditëse se, nga ana e palës së paditur DRT Sarandë, subjektit P.B i është mohuar e drejta për informim dhe e drejta për t’u dëgjuar, është një vlerësim dhe pretendim i gabuar i cili nuk është i bazuar në ligj dhe në prova. Në rastin konkret palës paditëse i janë vënë në dispozicion si njoftim vlerësimet po ashtu dhe akt rivlerësimet e mbajtura në lidhje me arsyet e llogaritjes së detyrimeve të tij tatimore. Pala paditëse nuk pretendon se nga DRT Sarandë nuk i është dhënë informacion në lidhje me ndonjë kërkesë të tij për të marrë informacion në lidhje me detyrimet e nxjerra për këtë subjekt. Gjykata Administrative vlerëson se me të drejtë pala e paditur ka pretenduar

se nuk jemi në kushtet e pavlefshmërisë absolute të akteve, për faktin se mosnjoftimi dhe mosdëgjimi i subjektit nuk kanë lidhje me nxjerrjen e detyrimeve tatimore.

Në këto kushte, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se aktet administrative objekt shqyrtimi gjyqësor nuk përfshihen në asnjë nga rastet e pavlefshmërisë absolute të parashikuar nga neni 108 të ligjit nr.44/2015 të K.Pr.Administrative, sikundër pretendon pala paditëse. Përkundrazi, aktet kanë dalë në zbatim të Ligjit nr.9920/2008, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr.19, datë 03.11.2014 “Për Zbatimin e Regjimit të Veçantë të Skemës së Kompensimit të Prodhuesve Bujqësorë për Qëllime të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar”.

Konkretisht, shkak i penalizimit të palës paditëse janë bërë verifikimi i blerjeve të subjektit të mësipërm për muajt janar-tetor 2015.

Bazuar në të dhënat e regjistrit të fermerëve pranë DRT Sarandë, rezulton se ky tatimpagues nuk ka njoftuar DRT Sarandë dhe nuk ka depozituar akt-marrëveshjet me fermerët e deklaruar në librin e blerjeve për periudhën janar-tetor 2015 përpara se të fillonte aplikimin e skemës së kompensimit të fermerit.

Për këtë shkelje të konstatuar, DRT Sarandë ka mbajtur aktet e rivlerësimit përkatës dhe ka nxjerrë njoftim vlerësimit për detyrimet tatimore nr.\_\_\_\_ Prot., datë 13.04.2016 dhe nr.\_\_\_\_ Prot., datë 13.04.2016, çka do të thotë se rivlerësimi i kryer për palën paditëse është kryer në respektim të ligjit, pasi ky subjekt nuk ka depozituar pranë DRT Sarandë akt-marrëveshjet e lidhura me fermerët përpara se të fillonte të aplikonte skemën e kompensimit.

Kolegji vlerëson gjithashtu se dhe vendimi i DAT nr.\_\_\_\_, datë 28.07.2016, është një vendim i dhënë nga një organ i identifikuar në përmbushje të neneve 106, 107, 108, të ligjit 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe pikës 106.2.4 dhe 106.2.6 të UMF nr.24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nuk ka asnjë element të pavlefshmërisë absolute, sikundër pretendohet nga Gjykata e Shkallës së Parë Gjirokastrë dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi.

Gjykata Administrative e Apelit, bazuar dhe në ankimin e palës së paditur dhe pretendimet e paraqitura prej saj në shkallë të parë, arrin në konkluzionin se ka shkaqe që diktojnë në ndryshimin e vendimit të shkallës së parë duke rrëzuar kërkesëpadinë si të pabazuar në ligj dhe në prova.

### **Vendimi i Gjykatës:**

1. Ndryshimin e vendimit nr.759, datë 01.12.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.
2. Rrëzimin e kërkesëpadisë.
3. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditëse.
4. Kundër vendimit lejohet e drejta e rekursit në Gjykatën e Lartë.

#### **4. Vendim Nr. (82-2021-1282) 368, datë 17.11.2021**

##### **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës**

**Paditës:** Shoqëria "G.A" sh.p.k me Nipt \_\_\_\_\_

**Të paditur:** 1. Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan  
2. Drejtoria e Apelimit Tatimor  
3. Drejtoria e Hetimit Tatimor Rajoni Qendror

**Objekti:** Kundërshtimi i plotë i aktit administrativ, Njoftim Vlerësimi me nr.\_\_\_\_ Prot., datë 28.08.2018, që ka të bëjë me pagesën e detyrimeve për gjobë për periudhën tatimore 2018.08, detyrime që rrjedhin nga Akt Konstatimi me nr.\_\_\_\_, datë 17.08.2018 dhe Procesverbali i gjobës me nr.\_\_\_\_, datë 17.08.2018, me vlerë 200.000 lekë.

**Shuma e detyrimit tatimor: 200.000 lekë.**

**Baza Ligjore :** Ligji nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar; Ligji nr.9920, datë 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; Ligji nr. 9136, datë 11.09.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore.

**Përmbledhje e Fakteve:** Ndaj paditësit "G.A" sh.p.k me Nipt \_\_\_\_\_, subjekt nën administrimin e DRT-Elbasan, është ushtruar kontroll nga strukturat e autorizuara të administratës tatimore, sipas urdhrorit të punës nr.\_\_\_\_Prot., datë 13.08.2018, mbajtur në adresën ku ushtron veprimtarinë subjekti "G.A" sh.p.k.

Shoqëria "G.A" sh.p.k është ngarkuar me detyrimet nëpërmjet Njoftim-Vlerësimit me nr.\_\_\_\_ Prot., datë 28.08.2018. Vlerësimi Tatimor është rrjedhojë e Akt-Konstatimit nr\_\_\_\_, datë 17.08.2018, si dhe i Procesverbalit të gjobës me nr.\_\_\_\_, datë 17.08.2018, me anë të të cilit ndaj subjektit është vendosur gjobë në vlerën 200.000 lekë.

Sipas Akt-konstatimit, rezulton se në momentin e kontrollit në punë është gjendur zj. B.Gj (Shitëse) me ID \_\_\_\_\_, e padeklaruar në organet tatimore, pas verifikimit të kryer në sistemin C@TS. Bazuar në nenin 119, pika 1, gërma a) të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, u mbajt procesverbali i gjobës me nr. serie \_\_\_\_\_, datë 17.08.2018.

##### **Vlerësimi i Gjykatës**

Fakti që Zj. B.Gj është konstatuar në ambientet e biznesit të palës paditëse, nuk passjell apriori se kjo shtetase është punonjëse e kësaj shoqërie, përse kohë nga inspektorët e palës së paditur nuk është kryer një hetim i plotë dhe i thelluar për të verifikuar pretendimin e palës paditëse se kjo shtetase ndodhet në ambientet e biznesit në kuadër të kryerjes së detyrës së saj si agente shitje e shoqërisë "DD" sh.p.k.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se, nga pala e paditur nuk janë kryer veprimet e nevojshme për të verifikuar statusin e punësimit të Zj. B.Gj pranë shoqërisë "DD" sh.p.k por, në mënyrë të gabuar inspektorët janë mjaftuar vetëm me faktin se kjo shtetase është gjendur në ambientet tregtare të palës paditëse dhe rrjedhimisht është punonjëse e kësaj shoqërie që nuk është deklaruar pranë organeve tatimore, ndërkohë që nga të gjitha provat e administruara gjatë gjykimit rezultoi e provuar se kjo shtetase është e punësuar pranë shoqërisë "DD" sh.p.k dhe e deklaruar regullisht pranë organeve tatimore nga kjo shoqëri si e punësuar dhe ndodhej në ambientet e biznesit të palës paditëse në kuadër të përmbushjes së detyrës së saj si agjente shitje.

Një akt administrativ është i paligjshëm në ato raste, kur urdhërimet e tij nuk janë në përputhje me urdhërimet e ligjit, [d.m.th.](#) përmbajtja e aktit administrativ bie ndesh dhe nuk respekton përmbajtjen e vetë ligjit. Pra akti është i paligjshëm e si rrjedhojë ai nuk mund të krijojë as pasojat e dëshiruara juridike. Në këtë kuptim, një nga kërkesat kryesore që akti administrativ të jetë i ligjshëm, është që përmbajtja e tij të jetë e njëjtë, të përafrojë dhe të mos e kundërshtojë përmbajtjen e vetë ligjit, në zbatim të të cilit ai është nxjerrë.

Sa më sipër, gjykata vlerëson se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me parashikimet ligjore të posaçme, duke sjellë si pasojë paligjshmërinë e aktit objekt gjykimi bazuar në nenin 109/d të Kodit të Procedurës Administrative.

Njoftim Vlerësimi Tatimor nr.\_\_\_\_ Prot., datë 28.08.2018, i DRT-Elbasan, lënë në fuqi me vendimin nr.\_\_\_\_ Prot., datë 15.11.2018, të Drejtorisë së Apelimit Tatimor, është një akt administrativ i nxjerrë në kundërshtim me parashikimet e ligjit të posaçëm dhe rrjedhimisht i paligjshëm në vështrim të parashikimeve të nenit 109/d të Kodit të Procedurave Administrative, për këtë arsye duhet të shfuqizohet nga gjykata.

## **Vendimi i Gjykatës**

- ✓ Pranim i kërkesëpadisë.